



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 442 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 68 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Dinamika të zhvillimit të shoqërive gjatë periudhës së bronzit të vonë dhe të hekurit në Pellgun e Korçës" 2019*, drejtuar nga Dr. Rovena Kurti (IA) dhe Dr. Cecile Oberweiler (Shtëpia e Arkeologjisë dhe Etnologjisë R. Ginouvès /Universiteti i Nanterre/Paris-Francë), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Dinamika të zhvillimit të shoqërive gjatë periudhës së bronzit të vonë dhe të hekurit në Pellgun e Korçës" 2019*, drejtuar nga Dr. Rovena Kurti (IA) dhe Dr. Cecile Oberweiler (Shtëpia e Arkeologjisë dhe Etnologjisë R. Ginouvès /Universiteti i Nanterre/Paris-Francë), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i vëzhgimit arkeologjik në vendbanimet e lartësive kodrinore (shumica të fortifikuara) nga Pellgu i Korçës, përqendruar në sitet përreth pjesës veriore të fushës.
 - Sondazh arkeologjik në "kalanë" e Barçit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al